



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Mars 2021

Nr: 113

VENDIM

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR PËRZGJEDHJEN E MONITORUESVE
NGA THIRRJA E DYTË PËR TË PLOTËSUAR NUMRIN E VAKANCAVE NË QARKUN E
TIRANËS, DURRËSIT, FIERIT, DIBRËS, SHKODRËS, KORÇËS, ELBASANIT DHE VLORËS**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit” dhe pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm

VËREN

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit, si dhe në përmbushje të detyrimit administrativ për njoftimin e palëve, ka bërë njoftim publik për rihapjen e aplikimeve për monitorues për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 për të plotësuar numrin e 32 (tridhjetë e dy) vakancave për qarqet Durrës, Fier, Dibër, Berat, Shkodër, Korçë, Elbasan, Lezhë dhe Vlorë. Ky njoftim publik është realizuar nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit.

Pas njoftimit publik, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zbatim të udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”, kanë depozituar dokumentacionin 50 (pesëdhjetë) aplikant të interesuar për monitorues për qarqet e sipërcituara.

Komisioni i Posaçëm i ngritur për verifikimin e plotësimit të kriterëve formale të aplikantëve për monitorues dhe procedurën e intervistimit me kandidatët e kualifikuar shqyrtoi të gjitha aplikimet e depozituara dhe përzgjodhi listën prej 48 (dyzet e tetë) kandidatëve për monitorues duke përjashtuar 2 (dy) aplikantë për konflikt interesi pasi ishin punonjës të Bashkive të qarqeve ku kishin bërë kërkesën për të aplikuar si monitorues.



Të 48 (dyzet e tetë) kandidatët për monitorues plotësojnë kriteret e përcaktuara të udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”.

Për sa më sipër shorti për emërimin e monitoruesve u organizua për qarkun Durrës, Fier, Dibër, Shkodër, Korçë, Elbasan, dhe Vlorë. Për sa i përket qarkut Berat duke qenë se numri i vakancave ishte 1 (një) dhe kishte 1 (një) aplikim nuk u hodh shorti, ndërsa për sa i përket qarkut të Lezhës duke qenë se ka patur më pak aplikime se vakancat, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka nxjerrë një njoftim të tretë lidhur me pjesëmarrjen që nevojitet për qarkun e Lezhës për të plotësuar vakancat e mbetura. Gjithashtu për shkak të 1 (një) vakance që u krijua në qarkun e Tiranës u hodh dhe shorti për këtë qark.

Më datë 04.03.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi shortin për përzgjedhjen e monitoruesve për qarkun Tiranë, Durrës, Fier, Dibër, Shkodër, Korçë, Elbasan dhe Vlorë.

Në një enë transparente u futën 32 (tridhjetë e dy) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 32 (tridhjetë e dy) kandidatëve për monitorues pjesëmarrës nga Tirana për qarkun Tiranë, nga të cilët u përzgjedhën 1 (një) monitorues. Pas përzgjedhjes së monitoruesit për qarkun Tiranë vijoi shorti për përzgjedhjen e vakancave për qarqet e tjera. Në një enë transparente u futën 8 (tetë) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 8 (tetë) kandidatëve për monitorues pjesëmarrës për plotësimin e 3 vakancave në qarkun Durrës, nga të cilët u përzgjedhën 3 (tre) monitorues. Në një enë transparente u futën 9 (nëntë) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 9 (nëntë) aplikantëve për monitorues pjesëmarrës për plotësimin e 7 (shtatë) vakancave në qarkun Fier, nga të cilët u përzgjedhën 7 (shtatë) monitorues. Në një enë transparente u futën 4 (katër) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 4 (katër) aplikantëve për monitorues pjesëmarrës për plotësimin e 3 (tre) vakancave në qarkun Dibër, nga të cilët u përzgjedhën 3 (tre) monitorues. Në një enë transparente u futën 4 (katër) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 4 (katër) aplikantëve për monitorues pjesëmarrës për plotësimin e 2 (dy) vakancave në qarkun Shkodër, nga të cilët u përzgjedhën 2 (dy) monitorues. Në një enë transparente u futën 6 (gjashtë) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 6 (gjashtë) aplikantëve për monitorues pjesëmarrës për plotësimin e 4 (katër) vakancave në qarkun Korçë, nga të cilët u përzgjedhën 4 (katër) monitorues. Në një enë transparente u futën 9 (nëntë) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 9 (nëntë) aplikantëve për monitorues pjesëmarrës për plotësimin e 5 (pesë) vakancave në qarkun



Elbasan, nga të cilët u përzgjedhën 4 (katër) monitorues, pasi 1 (një) prej monitoruesve të përzgjedhur në përfundim të shortit solli kërkesë për dorëheqje për arsye personale. Në një enë transparente u futën 6 (gjashtë) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 6 (gjashtë) aplikantëve për monitorues pjesëmarrës për plotësimin e 4 (katër) vakancave në qarkun Vlorë, nga të cilët u përzgjedhën 4 (katër) monitorues.

PËR KËTO ARSYE

Referuar nenit 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”

V E N D O S

1. Të miratoj listën e monitoruesit për vakancën në qarkun Tiranë, i cili do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
 - 1) Milirjan Horanlliu
2. Të miratoj listën e monitoruesve për vakancat në qarkun Durrës, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
 - 1) Joana Lelo
 - 2) Andrea Pula
 - 3) Silvana Basha
3. Të miratoj listën e monitoruesve për vakancat në qarkun Fier, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
 - 1) Ilirjan Elezi
 - 2) Dafina Tafa
 - 3) Armand Kallaji
 - 4) Ledion Nako
 - 5) Ingrid Jokiçi



- 6) Gleni Bego
 - 7) Arta Duka
4. Të miratoj listën e monitoruesve për vakancat në qarkun Dibër, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
- 1) Ismail Lleshi
 - 2) Glantuela Abazi
 - 3) Rubina Osmanaj
5. Të miratoj listën e monitoruesve për vakancat në qarkun Shkodër, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
- 1) Besmir Murati
 - 2) Paulin Peci
6. Të miratoj listën e monitoruesve për vakancat në qarkun Korçë, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
- 1) Odise Kotka
 - 2) Genci Nisi
 - 3) Denajda Dushku
 - 4) Mishel Ninga
7. Të miratoj listën e monitoruesve për vakancat në qarkun Elbasan, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
- 1) Erjon Xhakollari
 - 2) Geis (Bega) Naço
 - 3) Robert Hasa
 - 4) Keneda Dushku
8. Të miratoj listën e monitoruesve për vakancat në qarkun Vlorë, të cilët do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
- 1) Nertila Bregaj
 - 2) Artil Çela



- 3) Entela Çipa
- 4) Albana Cika

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

